



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:196452

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04855762

PPP. nr. 225/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të Kreditorit N.T.P “D...”, Komuna Gllogoc, kundër debitorit N.S nga Komuna Gllogoc, lidhur me borxhin në shumën prej 1,049.30 €, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit Y.K, P.nr... të datës 16.07.2019, dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datën 18.05.2022 ku ishin prezent kreditori dhe përfaqësuesi i tij me autorizim H.M dhe debitori personalisht, jashtë seancës me datën 30.10.2023 gjykata e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET: prapësimi i debitorit N.S nga Komuna Gllogocit, ushtruar kundër Urdhërit të Përmbartuesit Privat Y.K, P.nr... të datës 16.07.2019 me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit N.T.P “D...” Komuna Gllogoc për përmbartimin e borxhit në shumën prej 1,049.30 €, ndërsa urdhëri i Përmbartuesit Privat Y.K, P. nr... i datës 16.07.2019 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Y.K, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Faturës Nr... të datës 06.05.2013 i cili është dokumenti besueshëm dhe i cili sipas Nenit 21 të LPP-së paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit ndërsa në bazë të Nenit 40 të këtij ligji është dokument i besueshëm.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit, në afat ligjor debitori ka paraqit prapësim, me arsyetimin se: *kërkesa e kreditorit lidhur me borxhin e mbetur në emër të kinse borxhit të mbetur lidhur me materialin ndërtimor nuk qëndron në asnjë pikëpamje, për faktin se në 9 vitet e fundit asnjë material ndërtimor nuk është futur në oborrin e debitorit, poashtu fatura e paraqitur në propozim dhe urdhëri i përmbartuesit privat nuk përkon me faturën që ju është bashkëngjitur urdhërit për lejimin e përmbartimit, më tutje shton se ka parregullsi në këtë procedurë dhe ka kërkuar nga gjykata që të mbajë seancë gjyqësore për të i dëgjuar palët në mënyrë që të*

vërtetohet drejtë gjendja faktike, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj urdhërin përmbartimor me nr... të datës 16.07.2019.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilin ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se: *debitori e ka kontestuar kompetencën e përmbartuesit si dhe dokumentin e besueshëm por jo edhe borxhin të cilin ia ka kreditorit. Sa i përket Faturës nr... të datës 24.08.2016, kreditori të njëjtën e ka dërguar përmes postës meqenëse debitori nuk e ka pranuar në forma të tjera normale, duke i propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës në përgjithësi të e refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri të mbet në fuqi.*

Gjykata lidhur me këtë çështje ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 18.05.2022, në të cilën kanë prezantuar Kreditori E.G dhe përfaqësuesi i tij me autorizim H.M dhe debitori N.S personalisht. Në seancën e mbajtur përfaqësuesi i kreditorit ka deklaruar se: *propozimi për përmbartim është i bazuar në provat të cilat janë dorëzuar gjykatës, i njëjti i ka ofruar gjykatës të dhënat e firmosura nga vet debitori se përveç mallit të cilin e ka pranuar dhe ju është dorëzuar, evidencat nga hyrje daljet në subjektin e kreditorit dhe listën ku borxhi total saktësohet në 1,135.30 Euro, ndër të tjerash ka pasur raste se personalisht debitori të ketë marr edhe 50 kg miell përkatësisht gjithsejt 1200 kg miell duke u përmbushur në tërësi borxhi total në shumën e cekur më lartë.*

Debitori në atë seancë të mbajtur ka deklaruar se: *nuk i ka asnjë cent borxh kreditorit dhe në tërësi e ka kontestuar shumën e cila e ka caktuar në propozimin për përmbartim, po ashtu i ka kontestuar nënshkrimet të cilat janë prezantuar nga ana e kreditorit duke deklaruar se nuk janë nënshkrime të tij dhe nuk e din se çfarë malli ka marr kur kreditori të gjithë atë e përziën me miell dhe çështje tjera materiale ndërtimorë te cilat i ka marr disa herë, por e din se në tërësi borxhin për material ndërtimor e ka paguar, dhe po ashtu të njëjtit në vitin 2015 ka pasur të deponuar 750 kg grurë ku i ka rënë 382 kg miell dhe tërheqja e këtij mielli nuk është bërë nga ana e tij.*

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe propozimit të përfaqësuesit të kreditorit, në bazë të Aktvendimit të marr në procesverbal ka vendosur që të jepet afat prej 30 ditësh në mënyrë që palët ndërgjygjëse kreditori dhe debitori në bazë të dokumentacionit ekzistues faturat në dorëshkrim të ulen dhe të barazohen dhe të pajtohen rreth borxhit, të njëjtin janë paralajmëruar se nëse brenda afatit ligjor nuk arrin marrëveshje dhe nuk e informojnë gjykatën në formë të shkruar atëherë gjykata do të vendos në mënyrë meritore.

Meqenëse palët ndërgjygjëse nuk e kanë njoftuar gjykatën lidhur me ecurinë e çështjes pas dhënies së afatit prej 30 ditësh, gjykata ka vendosur që të vazhdoj me procedurën në bazë provave në shkresat që gjenden në lëndë.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit i datës 05.08.2019 është i pabazuar, me faktin se në shkresat e lëndës gjendet fatura me nr... e datës 24.08.16 në të cilën vërtetohet fakti i shitblerjes së mallit ndërtimor dhe atë: Blloka G6 në vlerë 260 Euro, Rrjeta 6.0 150x150 në vlerë 153.30 Euro, cementi 42.5 FK 50/1 në vlerë 392.00 Euro, dhe hekur periodik në vlerë 244 Euro, që gjithsejt borxhi total është 1,049.30 Euro të cilën shumë debitori është i obliguar që të ia paguaj kreditorit, ndërsa nga prova siç është fotokopja e fletëkthimit nga posta në të cilën figuron se është pranuar posta e dërguar nga N.T.P D..., vërtetohet fakti se është pranuar nga një anëtar i familjes së debitorit.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke vendosur dhe atë duke u bazuar në Nenin 21 dhe 29 të LPP-së, kjo pasi që fatura është dokument i besueshëm, dhe në bazë të Nenit 29 par. 1 LPP-së që përcakton se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike; 2. Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm”*. Andaj, gjykata vendosi që të refuzoj prapësimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që faturat konsiderohen të jene dokumente të besueshme.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të Nenit 73 par. 3 të LPP-së kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 225/19 i datës 30.10.2023**

**Gj y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbartimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.